



Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“NË MBËSHTETJE TË ANTARSIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN”

Zgjerimi i Bashkimit European edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, e veçanërisht për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, është një proces inkurajues, i cili udhëhiqet nga kritere aderimi objektive, të qarta dhe të prekshme. Bazuar në shkallën e realizueshmërisë së kritereve, Ne, jemi të bindur se vullneti dhe vizioni i vendeve anëtare të Bashkimit European për ta pranuar Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut brenda familjes së saj të madhe do të jetë shumë shpejt një realitet i prekshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë.

Njëkohësisht, jemi të bindur se ky proces kalon nëpërmjet zbatimit të një sërë reformash nga vendi ynë. Reforma të cilat për nga rëndësia do ti konsideronim “jetike” dhe që e lidhin veprimtarinë e tyre më garantimin e një procesi të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe qëllimin kryesor të kësaj reforme, vendosjen e drejtësisë pa artifica të cilët e dëmtojnë rëndë organizimin dhe funksionimin e drejtësisë, reformimin e ekonomisë dhe garantimin e respektimit në mënyrë absolute të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjithësisht dhe të punonjësve në veçanti.

Nëpërmjet kësaj Rezolute, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë mbështet gjithashtu Deklaratën e ITUC dhe ETUC, datë 23.10.2019, miratuar nga Komiteti Ekzekutiv i tyre.

Miratimi i kësaj Rezolute duhet të kuptohet nga çdokush, aktor, faktor apo qytetar i thjeshtë, brenda dhe jashtë Shqipërisë, si një instrument që nxit vendin tonë të adresojë sfidat dhe të vlerësojë rolin e pamohueshëm të patnerëve social në ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të udhëhequr nga parime demokratike. Në mbështetje të proceseve integruese ne do ti kërkojmë Qeverisë Shqiptare të respektojë plotësisht të drejtat dhe liritë themelore të punonjësve, në përputhje me standartet ndërkombëtare, si dhe të sigurojë sundimin dhe zbatimin e ligjit dhe të promovojë modelin social europian.

Për sa më lart, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, si një aktor dhe faktor social potencial i bën thirrje Bashkimit European për të hapur procesin e negociatave për antarsimin e Shqipërisë në Bashkimin European, pasi hapja e procesit të negociatave garanton, siguron dhe adreson zgjidhjet ekonomike, sociale dhe politike të vendit tonë, përfshirë këtu edhe sindikatat si pjesë integrale e zgjidhjeve dhe zgjedhjeve në kuadër të këtij procesi.

Gjithashtu, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë i bën thirrje edhe Parlamentit European për të riformuluar politikën e zgjerimit të Bashkimit European, duke i kushtuar më shumë vëmendje të drejtave të punonjësve dhe mbrojtjes sociale, duke garantuar një përfshirje të plotë të sindikatave në këto procese.”

Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së



Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“PËR BARAZINË GJINORE DHE RATIFIKIMIN E KONVENTËS NR.190 “PËR DHUNËN DHE NGACMIMIN”, SI DHE REKOMANDIMIN NR 206 -PËR DHUNËN DHE NGACMIMIN”

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e vlerëson barazinë gjinore si një kusht përcaktues për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme, solidare, të emancipuar dhe ekonomikisht të zhvilluar, prandaj punën e saj për barazinë gjinore e konsideron si një objektiv dhe prioritet angazhimi për të vepruar, bashkëpunuar dhe koordinuar punën me të gjithë aktorët, të cilët besojnë se promovimi i barazisë gjinore do të thotë kontribut për një shoqëri demokratike, të hapur dhe të emancipuar, në thelb, kontribut për një shoqëri me parime dhe principe të larta europiane. Në këtë kontekst, ne do të punojmë për të eliminuar hendekun gjinor në paga, shpërblime dhe pensione. Realizimi i këtij objektivi e vendos KSSH-në përballë një sfide, realizimi i të cilës sjell attribute të merituar për shoqërinë shqiptare.

Ne, respektojmë dhe kemi ndjeshmëri ndaj nevojave të veçanta të të dy gjinive, ne njohim, vlerësojmë dhe respektojmë diversitetit, ne jemi të angazhuar për tolerancë zero kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, dhunës në familje, si dhe kundër çfarëdo lloj forme të dhunës. Me iniciativën e KSSH-së, tanimë Qeveria Shqiptare filloi punën për ratifikimin e Konventës Nr. 190 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) “Për Dhunën dhe Ngacmimin” shoqëruar nga Rekomandimi Nr. 206 të ILO-s “Për Dhunën dhe Ngacmimin”, të cilat kanë për qëllim parësor garantimin e një mjedisi pune pa dhunë me bazë gjinore dhe pa ngacmime në vendin e punës.

KSSH, duke njohur dhe respektuar të drejtën e gjithësecilit për një botë pune pa dhunë dhe pa ngacmime seksuale do të referojë dhe adresojë të gjitha sjelljet dhe praktikatat e papranueshme, si dhe të gjitha kërcënimet të bëra grave dhe vajzave, qofshin këto një dukuri e vetme apo një fenomen i përsëritur, i cili mund të rezultojë në dhunë fizike, dëm psikologjik, seksual ose ekonomik.

Miratimi i kësaj Konvente ka një fushë të gjërë zbatimi, pasi pas miratimit të saj mbrohen jo vetëm të gjithë punonjësit, por edhe të gjithë personat e tjerë të cilët janë të përfshirë në botën e punës dhe që sipas praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare, pavarsisht nga statusi i tyre kontraktues në punë, si punëmarrës, persona në trajnim, praktikantë, vullnetarë, punëkërkes ose individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat apo përgjegjësitë e një punëdhënësi, ata janë subjekte që përfitojnë mbrojtje nga dispozitat e kësaj Konvente me rëndësi jetike për shoqërinë shqiptare.

Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së.



Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“PËR RITJES E PAGËS MINIMALE DHE PËRCAKTIMIN E MINIMUMIT JETIK ZYRTAR”

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e ka konsideruar rritjen e pagave në tërësi dhe atë të pagës minimale dhe përcaktimin e minimumit jetik në veçanti, jo si një apstraksion ekonomik, por si një burim jetësor i domosdoshëm për punëtorët dhe qytetarët. Aktualisht paga minimale në Shqipëri është 26 mijë lekë, e cila jepet për 174 orë pune në muaj, me pagë bazë minimale orare 149 lekë. Kjo pagë jepet për 156 mijë të punësuar, ose 29.6 % e totalit të të punësuarve. Në sektorin publik me këtë pagë paguhen vetëm 1% e punonjësve, pjesa tjetër i përkasin sektorit privat.

Këto shifra vërtetojnë qartë se kjo pagë minimale është nën “normat e tregut” dhe si e tillë ajo tashmë ka krijuar pakënaqësi, demotivim dhe shpesh kundërshti e konflikte sociale. Të ndodhur në këto rrethana, si dhe në respektim të Konventës 131 të ILO-s për pagën minimale dhe në zbatim të Nenit 4 të Kartës Sociale Europiane (e nënshkruar nga shteti ynë), e cila thekson se “*Nuk konsiderohet në përputhje me kartën nëse paga minimale zbret nën 60 % të pagës mesatare neto kombëtare*”, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë i kërkon Qeverisë Shqiptare rritjen e pagës minimale në 33 mijë lekë që nga Janari 2020 dhe në 26 mijë lekë nga Janari 2021, si dhe shpalljen e minimumit jetik zyrtar. Kërkesa jonë ka bazueshmëri dhe logjikë ekonomike, e cila lidhet me aftësitë konkurruese të ekonomisë tonë. Kjo kërkesë merr parasysh edhe ndryshimin e dinamikës së përgjithshme të pagave që pësohet nga kjo rritje, normën e inflacionit nga viti në viti, si dhe aftësitë e buxhetit të shtetit për të përballuar këtë rritje (për punonjësit buxhetor), si dhe me aftësinë konkurruese të pagave të bizneseve vendase dhe të huaja që operojnë në Shqipëri në sektorin privat.

Rritja e pagës minimale dhe miratimi zyrtar i minimumit jetik bëhet domosdoshmëri, jo vetëm për të ri-rregulluar shpërndarjen e produktit në të gjithë piramidën e sistemit të pagave dhe shpërblimeve sociale, por ajo nxit rritjen e pensioneve, favorozon punësimin, rrit ndihmën ekonomike, pagesat e paaftësisë dhe përfitime të tjera bazike, të cilat fatkeqësisht në mënyrë të frikshme po e rrisin nivelin e varfërisë në shtrirje dhe në thellësi.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë e shikon si prioritet të saj rritjen e pagës minimale pasi ajo shërben për rritjen dhe përmirësimin zinxhir të pagës reale, mbështetjen e pagës tek produktiviteti, nxitjen dhe zhvillimin e dialogut social më efektiv, me synim adaptimin më të mirë të gjithë politikës së pagave.

Rritja e pagës minimale do të japë direkt efekte pozitive në uljen e varfërië monetare duke rritur të ardhurat dhe për rrjedhojë duke nxitur dhe rritur konsumin. Nëpërmjet uljes së varfërisë monetare do të kemi një vlerësim real të çmimit të krahut të punës, do të kemi rritje të produktivitetit të punës, duke e bërë punën dinjitoze dhe nëpërmjet saj duke kontribuar direkt në përmirësimin e cilësisë së jeteës, në shëndetin e njerëzve, edukimin, arsimimin, punësimin, përfshirjen sociale, garantimin e lirisë dhe të shprehjes për përfaqësuesit e punëtorëve.

Miratuar në Kongresin e 6-të të KSSH-së.



Tiranë, më 09.11.2019

REZOLUTË

“PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, PRIORITET I KSSH-SË”

Kongresi i 6-të i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë e vlerëson sigurinë dhe shëndetin në punë si prioritet të punës së saj, duke vlerësuar shqetësuese situatën aktuale në këtë fushë..

“Në vendin tonë siguria dhe shëndeti në punë përbën aspektin më të rëndësishëm të garantimit të një marrëdhënie pune në përputhje me standardet e pranuar, si nga legjislacioni kombëtar, ashtu edhe nga ai ndërkombëtar, si: Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), Kartës Evropiane Sociale të rishikuar dhe Direktivat e Bashkimit Evropian.

Sigurinë dhe shëndetin në punë, KSSH, e shikon dhe e vlerëson si një çështje thelbësore të lidhur direkt me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve që përbëjnë rrezik dhe që janë burim aksidentesh, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar, si dhe trajnimin dhe formimin e punëmarrësve dhe të përfaqësuesve të tyre, në përputhje me legjislacionin dhe standartet ndërkombëtare të pranuar.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë do ti kërkojë Qeverisë dhe do të bashkëpunojë për ngritjen dhe funksionimin e “Këshillit Ndër-Ministror për Çështjet e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, i cili do të ndjekë dhe rekomandojë çështjet e zbatimit të legjislacionit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Gjithashtu, ne do të angazhohemi për përmirësimin e dialogut social në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, përmes dialogut, negocimit, hartimit dhe nënshkrimit të Kontratave Kolektive të Punës, të cilat do të jenë të hartuara me dispozita efektive për procesin e ngritjes, funksionimit dhe vënien në praktikë të Këshillave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, në nivel ndërmarrje dhe sektori, në kompani private dhe publike, të gjitha në përputhje me legjislacionin përkatës.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë angazhohet që në përputhje me misionin e saj dhe konform qasjes europiane ndaj problemeve të sigurisë dhe shëndetit në punë, të referojë dhe adresojë në organet kompetente të gjitha praktikatat, të cilat i shërbejnë parandalimit, nëpërmjet identifikimit dhe kualifikimit të risqeve afatgjata dhe afatshkurtra dhe më pas duke ndërhyrë për të parandaluar, shmangur apo zbutur në minimum efektet e tyre.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë kërkon rritjen e përgjegjësisë dhe forcimin e zbatimit të ligjit nga autoritetet shtetërore publike, përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë. Domosdoshmëri duhet të jetë ngritja dhe funksionimi i “Mjekësisë së Punës” duke e futur atë si kurikul universitare, duke certifikuar dhe diplomuar mjekë pune dhe duke hartuar dhe publikuar rregjistrin kombëtar të mjekëve të punës.

KONFEDERATA E SINDIKATAVE TE SHQIPERISE
CONFEDERATION OF THE TRADE UNIONS OF ALBANIA

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë angazhohet për të punuar në lidhje me përshtatjen e punëve dhe teknologjive të reja, në mënyrë që ti përgjigjemi si dhe sa duhet ritmit të zhvillimit të epokës së dixhitalizimit të ekonomisë dhe pasojave që rrjedhin prej saj. Duke mos anashkaluar sektorët me rezikshmëri tradicionale si transporti, ndërtimi, minierat, industria kimike, fasoneritë, bujqësia, etj.

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë angazhohet për të rritur më tej bashkëpunimin midis punëmarrësve, punëdhënësve dhe shtetit, me qëllimin final për të perfeksionuar institucionalizimin e marrëdhënieve të patneritetit social, e për të zhvilluar një dialog social të suksesshëm e produktiv, ku çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë të jenë kryefjalë e debatit në tryeza dhe e negocimit në nënshkrimin e Kontratave Kolektive.

Miruar në Kongresin e 6-të të KSSH-së

